



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 dhjetor 2020
Nr. ref.: RK 1672/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI138/19

Parashtrues

Ibish Rraci

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA. nr. 506/2018, të 16 prillit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ibish Rraci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Klinë, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu dhe Qerkini".

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA. nr. 31/2019, të 16 prillit 2019, i cili i ishte dorëzuar atij, më 10 maj 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shtator 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 24 shtator 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi dokumentacion shtesë. Të njëjtën ditë, nga Gjykata Themelore u kërkua fletëkthesa si dëshmi për pranimin e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit. Kësaj të fundit, në pajtim me ligjin, iu dërgua një kopje e kërkesës.
8. Më 27 shtator 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, informon Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar, parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar, më 10 maj 2019.
9. Më 21 tetor 2019, gjyqtari Bekim Sejdiu, në pajtim me nenin 18.1 (1,2) të Ligjit dhe rregullin (9) të Rregullores së punës, ka kërkuar nga Kryetarja e Gjykatës përjashtimin e tij nga të gjitha fazat e shqyrtimit dhe vendimmarrjes të rastit KI138/19, për shkak të konfliktit të interesit. Më 22 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës aprovoi kërkesën e tij, në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura të Ligjit dhe të Rregullores së punës.

10. Më 27 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues propozoi që shqyrtimi i kërkesës të shtyhet për plotësime me informata shtesë.
11. Më 2 dhjetor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë dosjen e plotë të lëndës.
12. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të rastit.
13. Më 10 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri e refuzoi pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës, duke i rekomanduar Gjykatës në përbërje të plotë që kërkesa të shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative

14. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është një pensionist, i cili për 41 (dyzet e një vjet), ishte punëtor i arsimit në Kosovë. Parashtruesi i kërkesës, përveç pensionit kontributpagues të moshës, realizonte të ardhura personale edhe nga pensioni i invalidit të luftës. Ky fakt me pas ka ngritur kontest mes tij dhe autoriteteve përkatëse.
15. Më 15 shtator 2016, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve (në tekstin e mëtejme: MPMS), mori vendim për ndërprerjen e pensionit kontributpagues të moshës, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ishte përfitues i pensionit të invalidëve të luftës dhe sipas Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nuk mund të jetë përfitues i dy skemave pensionale njëkohësisht.
16. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në shkallën e dytë të MPMS-së, kundër vendimi të shkallës së parë të MPMS-së, të 15 shtatorit 2016, për shkak të mos arsyetimit të vendimit dhe shkeljes së të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare.
17. Më 18 dhjetor 2016, shkalla e dytë e MPMS-së, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke arsyetuar se në bazë të nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, “pala nuk ka të drejtë ligjore për përfitimin e dy pensioneve nga skemat pensionale”.

Procedura gjyqësore (konflikti administrativ)

18. Më 25 maj 2017, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përmes së cilës kërkoi anulimin e vendimit të MPMS-së, të 15 shtatorit 2016, nga arsyet vijuese:

“Konsideroj se ky vendim është i padrejtë, sepse ai cenon të drejtat e mia kushtetuese, përkatësisht: të drejtën në vendim të arsyetuar (neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës); të drejtën e pronës (neni 46 i

Kushtetutës së Republikës së Kosovës); të drejtën për mosdiskriminim (nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

“Mohimi i të drejtës për të gëzuar njërin nga këto pensione, në këtë rast atë të pensionit kontributdhënës si dhe atij të pleqërisë, me privon nga pritja legjitime për të ardhura financiare-qe përben element themelor të së drejtës së pronës.

Më tutje, konsideroj se kjo situatë juridike me ve në pozitë të pabarabartë, përkatësisht me diskriminon në raport me qytetar të tjerë të Republikës së Kosovës. Ky trajtim diskriminues shtrihet në dy drejtime; Së pari, unë diskriminohem në krahasim me shtetas të tjerë të Republikës së Kosovës të cilët edhe me tej vazhdojnë të përfitojnë nga të dy skemat pensionale në fjalë. Së dyti, ky vendim, përkatësisht ky trajtim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me ve në pozitë diskriminuese nga zyrtar të tjerë shtetëror të Republikës së Kosovës të cilët vazhdojnë të përfitojnë të ardhura personale nga dy apo më shumë kontrata/vende pune, të cilat si burim financiar kanë buxhetin e Republikës së Kosovës...Është standard i pranuar përgjithësisht se trajtimi i pabarabartë i individëve, në rrethana të njëjta, pa ndonjë arsye objektive dhe pa ndonjë masë proporcioni, përben diskriminim. Ndalimi i diskriminimit është një ndër normat themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (nenet 3 dhe 24).

Duke u nisur nga këto fakte, përmes kësaj padie kërkoj nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative qe të anulohet vendimin e Komisionit Ministror për rastin tim, të datës 28.12.2016, për shkak se ai vendim nuk është i arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe në pajtim me të drejtën për vendim të arsyetuar, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Nëse Gjykata Themelore nuk e gjen të arsyeshme pranimin e kërkesës time për anulimin e vendimit të cekur me sipër, kërkoj qe kjo Gjykatë të vlerësoj kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 04/L-131 dhe të njëjtin ta referojë në Gjykatën Kushtetuese për ta shpallur jo-kushtetues për shkak se cenon të drejtën për mosdiskriminim (nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës).”

19. Më 26 nëntor 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti për çështje administrative, me Aktgjykimin A.nr.829/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi ligjshmërinë e vendimit të MPMS-së, të 15 shtatorit 2016, duke arsyetuar se:

“... vendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të tij.”

20. Më 14 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se:

“... Gjykata Themelore, ka anashkaluar tërësisht pretendimin tim themelor, duke u marrur vetëm me mënyrën se si MPMS ka zbatuar Ligjin në fjalë. Pra në vend që të vlerësonte kushtetutshmërinë e Ligjit në fjalë, sidomos nenin 16 të tij, apo këtë t’ia dërgonte Gjykatës Kushtetuese, ...Kjo përbën shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për faktin se një vendim i cili nuk trajton fare pretendimin kryesor të padisë nuk mund të jetë vendim i drejtë në kuptim kushtetues. Për këto arsye kërkoj nga Gjykata e Apelit që të pranoj ankesën time dhe të shfuqizojë vendimin e Gjykatës Themelore.”

21. Më 16 prill 2019, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin AA. nr. 506/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit, ndaj pretendimit të parashtruesit të kërkesës të ngritur në ankesë, se Gjykata Themelore në Prishtinë ka bërë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, për faktin se nuk e kishte adresuar fare pretendimin e tij kryesor, në lidhje me jokushtetutshmërinë e nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, arsyetoi si më poshtë:

“... kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të paqëndrueshme ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtën për qasje në gjykatë dhe vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, për arsye se gjykatat e rregullta nuk arsyetuan pretendimin e tij thelbësor sa i përket kushtetutshmërisë së nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti, duke pretenduar se ky nen është në kundërshtim me nenin 3,24 dhe 46 të Kushtetutës.
23. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me të drejtën e ushtrimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 16 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, nëpërmjet kontrollit incidental të kushtetutshmërisë, argumenton, si më poshtë:

“... neni 113.8 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], përcakton si në vijim: “Gjykatat kanë të drejtë t’i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.”

Ligji për Gjykatën Kushtetuese ka rregulluar më hollësisht këtë çështje, duke paraprë në nenin, citoj: “Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrahet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës. 2. Kërkesa do të specifikojë se cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.”
(...)

24. Sa i përket rëndësisë së shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës së nga vlerësimi i kushtetutshmërisë së normës varej gjykimi i meritave të rastit të tij, ai argumenton:

“...unë kam ngritur edhe në Gjykatën Themelore edhe në Gjykatën e Apelit çështjen e jokushtetushmërisë së nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131, për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti. Kam argumentuar se ky nen është jokushtetues, sepse shkakton pabarazi në mes të një kategorie përfituesish nga buxheti publik (pensionistët), në raport me shërbyesit tjerë publikë të Republikës së Kosovës. Poashtu, është shumë e dukshme se nga kushtetutshmëria e ligjit të kontestuar varet gjykimi i çështjes time gjyqësore.”

25. Në lidhje me mos arsyetimin e vendimeve gjyqësore nga gjykatat e rregullta, parashtruesi i kërkesës, argumenton, si në vijim:

“Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë bërë shkelje të së drejtës time të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo për faktin se këto gjykata në vendimet e tyre nuk kanë trajtuar fare pretendimin kryesor timin për kundër kushtetutshmërinë e nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti. Këto gjykata as nuk kanë arsyetuar se ligji në fjalë është kushtetues e as nuk e kanë dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, siç i obligon Kushtetuta. Ato kanë shmangur pa asnjë arsyetim adresimin e çështjes kryesore të ngritur nga unë, si në kërkesëpadinë e paraqitur në Gjykatën Themelore e poashtu edhe në ankesën e paraqitur në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit të saj, ka pranuar një vendim të Gjykatës Themelore i cili është marrë duke iu referuar një baze tërësisht të gabuar ligjore. Unë nuk e kontestoj se gjykatat kanë konstatuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, kur kanë vërtetuar se unë jam pensionit kontributdhënës (si mësimdhënës për më shumë se 4 dekada), veteran dhe invalid i luftës dhe se në bazë të Ligjit në fjalë nuk mund të përfitoj nga të gjitha skemat pensionale. Por ajo që unë kam ngritur si çështje kryesore gjatë tërë procesit gjyqësor, në shkallën e parë dhe të dytë, është cënimi i të drejtave të mia kushtetuese përmes nenit 16 të atij Ligji, sepse ai nen është jokushtetues.”

26. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës, më tej, argumenton se:

“Mosshqyrtimi i argumentimit tim kryesor të parashtruar shprehimisht pranë Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit i bënë vendimet në fjalë në shpërputhje me standardin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në bazë të interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm kërkon që gjykatat të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Arsyetimi i vendimeve është element themelor i gjykimit të drejtë. Siç ka theksuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin H kundër Belgjikës (viti 1987), vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar në mënyrë të sinqertë.”

27. Parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij për mosarsyetim të vendimit gjyqësor i mbështet në praktiken e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNj-së, duke argumentuar:

“Ndërsa Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në Aktgjykimin e saj në rastin KI135/14 (IKK Classic) ka argumentuar se "edhe pse gjykatat nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës, megjithatë ata duhet të adresojnë pretendimet që janë kryesore për rastet e tyre dhe të cilat ngrihen në të gjitha fazat e procedurës. Gjykata rithekson se e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në pajtim me ligjin përfshinë obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për vendimet e tyre me baza të arsyeshme, si në nivelin procedural po ashtu edhe material". Gjykata Kushtetuese e ka përsëritur edhe në vendime të tjera që standardi i vendimit të arsyetuar, në pajtim me praktikën e GJEDNj-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të mjaftueshme për vendimet e saj dhe të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (rasti Helle kundër Finlandës, 19 dhjetor 1997). Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. K172/12, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI35/14, IKK Classic, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 IKK Classic, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017).”

28. Si përmbledhje parashtruesi i kërkesës pretendon se:

“...Gjykata Themelore në vendimin e saj në rastin tim ka anashkaluar totalisht dhe pa asnjë shpjegim thelbin e padisë time, që ndërlihet me

jokushtetutshmërinë e Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti (nenin 16). Gjykata e Apelit nuk ka bërë korigjimin e kësaj shkeljeje të Gjykatës Themelore, por ka konfirmuar vendimin e gjykatës së shkallës më të ulët, duke shpërfillur pretendimin tim kryesor të paraqitur me ankesë. Rrjedhimisht, kjo e bën Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit si jokushtetuese, sepse ai është marrë me shkelje të parimit të vendimit të arsyetuar si element përbërës i të drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Gjykata e Apelit nuk ka marrë ndonjë qëndrim juridik se norma e sfiduar në aspektin e kushtetutshmërisë së saj a është me të vërtetë jokushtetuese, me çka parashtruesit i ka mohuar edhe të drejtën e qasjes në gjykatë e cila nuk duhet të jetë vetëm formale por duhet të jetë substanciale.”

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që:

“Kërkesën e paraqitësve të kërkesës ta konstatojë të pranueshme; Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Konventës Evropiane, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata e Apelit të njëjta të drejtash të garantuara për parashtruesin me këto instrumente dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore; Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të sfiduar me këtë kërkesë; Të urdhërojë kthimin e rastit në rivendosje. Të përcaktojë çfarëdo mase tjetër juridike që kjo Gjykatë e nderuar e vlerëson si të bazuar juridikisht dhe të arsyeshme.”

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...].”

32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

33. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka qartësuar aktin e autoritetit publik, kushtetutshmërinë e të cilit e konteston dhe të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë.
34. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullin (2), të Rregullores së punës, që përcakton:
- 2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*
35. Fillimisht, Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës detyron Gjykatën Kushtetuese që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
36. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e gjykatave të rregullta, shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës, për shkak të mostrajtimit të pretendimit të tij në lidhje me jokushtetutshmërinë e nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti, me nenet 3, 24 dhe 46 të Kushtetutës.
37. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk kërkon nga Gjykata vlerësimin e përputhshmërisë, me Kushtetutën, të nenit 16

të Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti me nenin 24 dhe 46 të Kushtetutës, por konstatimin e shkeljes së të drejtave të tij për gjykim të drejtë, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës, për arsye të mosadresimit të pretendimit të tij në lidhje me jokushtetushmerinë e normës së ligjit të lartcekur.

38. Prandaj, në rrethanat e këtij rasti, Gjykata do të vlerësojë nëse pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me jokushtetushmerinë e nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131), ishte adresuar nga gjykatat e rregullta në pajtueshmëri me të drejtën për një gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës.
39. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i Konventës, përcaktojnë:

Neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*

2. *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

Neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës

1. *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”*

Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNj-së

40. Gjykata, para së gjithash, rikujton se garancitë e përmbajtura në nenin 6. paragrafin 1 të Konventës, përfshijnë detyrën e gjykatave që të bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre. Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë (shih Aktgjykimin e GJEDNj-së *H. kundër Belgjikës*, kërkesa 8950/80, paragrafi 53, të 30 nëntorit 1987).
41. Gjykata, gjithashtu, thekson se sipas praktikës së GJEDNj-së, neni 6. paragrafi 1 i detyron gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga gjykatat të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GJEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], paragrafi 81.).
42. Lidhur me këtë, GJEDNJ shton se gjykata vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e pretendimeve dhe në lejimin e provave, por ajo

gjithashtu ka edhe obligimin që të justifikojë veprimet e saj duke dhënë arsytetime për vendimet e saj (shih Aktgjykimin e GJEDNj-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa 37801/97, të 1 korrikut 2003, paragrafi 36).

43. Gjithashtu, Gjykata thekson se në pajtim me praktikën e GJEDNj-së, gjatë shqyrtimit nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i plotëson standardet e të drejtës për gjykim të drejtë, duhet të merren parasysh rrethanat e rastit konkret. Vendimi gjyqësor nuk duhet të jetë pa asnjë arsyetim, as arsyetimi nuk duhet të jetë i paqartë. Kjo posaçërisht vlen për arsyetimin e vendimit të gjykatës e cila vendos sipas mjetit juridik, në të cilin janë ndryshuar qëndrimet juridike të paraqitura në vendimin e gjykatës më të ulët (shih rastin e GJEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61).
44. Gjykata dëshiron të theksojë se nocioni i një gjykimi të drejtë, në pajtim me praktikën e GJEDNj-së, gjithashtu kërkon që gjykata kombëtare e cila ka dhënë arsye të pakta për vendimet e saj, në të vërtetë të ketë adresuar çështjet themelore në kuadër të juridiksionit të saj, pra se nuk i kishte pranuar thjeshtë dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët. Kjo kërkesë është edhe më e rëndësishme në rast kur një palë në kontest nuk ka pasur mundësi për të paraqitur gojariisht rastin e saj në procedurën vendore (shih Aktgjykimin e GJEDNj-së *Helle kundër Finlandës*, kërkesa 157/1996/776/977, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60).
45. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017).

Zbatimi i parimeve të përmendura mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar në rastin konkret

46. Gjykata rikujton se gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A. nr. 247, dhe *B. Vidal kundër Belgjikës*, 22 prill 1992, f. 33, seria A. nr. 235).
47. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës pretendimin për jokushtetutshmërinë e nenit 16 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skema Pensionale të Financuara nga Shteti, fillimisht e kishte ngritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila me Aktgjykimin A. nr. 829/2017, të 26 tetorit 2018 e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e tij, me arsyetimin:

“Nga këto rrethana gjykata verën se vendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar Ligjin material. Mbi këto arsyeza kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dem të tij.”

48. Më tej, Gjkata vëren se Gjkata e Apelit, në Aktgjykimin e kontestuar AA.nr. 506/2018, të 16 prillit 2019, arsyetoi:

“...kjo gjykatë vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm se konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dem të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se në këtë rast është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për faktin se një vendim i cili nuk trajton fare pretendimin kryesor të padisë, nuk mund të jetë vendim i drejtë, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe paargumentuara, për tu aprovuar ankesa.”

49. Në këtë drejtim, Gjkata konsideron se Gjkata e Apelit i është përgjigjur pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, duke theksuar se një pretendim i tillë i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar nga shkak se i njëjti nuk ishte i mbështetur dhe i argumentuar në mënyrë bindëse. Gjkata tutje vlerëson se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të mjaftueshme që para Gjykatës së Apelit t'i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga Gjkata e Apelit.
50. Gjkata më tej rithekson se, në parim, “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohehen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës përkatëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 48; dhe KI49/19, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim për papranueshmëri i 8 janarit 2020, paragrafi 55).
51. Gjykatat, rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjkata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).

52. Edhe më tutje, Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
53. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNj, rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu, rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41). Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore.
54. Gjykata në këtë aspekt thekson se parashtruesi i kërkesave thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, andaj pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNj-së *Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
55. Andaj, Gjykata thekson se procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Apelit, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare që do ta bënin procesin të parregullt në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe 6.1 të Konventës (shih rastin e GJEDNj-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
56. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet deklaruar e papranueshme, si qartazi e pabazuar, sepse i njëjti nuk e ka mbështetur në baza kushtetuese pretendimin e tij, për shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës.
57. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2020, me shumicë votash:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi